

KOMUNA E LIPJANIT



**STRATEGJIA
e
ZHVILLIMIT
EKONOMIK LOKAL
2005 - 2007**

Mars 2005



**PROJEKTI: Zhvillimi i Ndërmarrjeve Lokale nëpërmjet
Aksionit dhe Aleançës (DELTA II)**

**Projekt për zhvillimin ekonomik, i bashkëfinancuar nga
Instituti për Shoqëri të Hapur, komunat pjesëmarrëse dhe
"Friedrich Ebert Stiftung"**



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Vërejtje

Kjo strategji është hartuar nga Ekipi Komunal, me këshilla dhe udhëzime të Grupit të Bankës Botërore, Institutit për Shoqëri të Hapur dhe "Riinvest"-it. Grupi i Bankës Botërore, Instituti për Shoqëri të Hapur dhe "Riinvest"-i nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e kësaj strategjie, sidoqoftë ato përgëzojnë Ekipin Komunal për cilësinë e punës.

PËRMBAJTJA

	Faqe
HYRJE	1
I. ORGANIZIMI I PËRPPJEKJEVE	3
II. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE	9
III. ANALIZA KONKURREUESE (SWOT)	19
IV. VIZIONI	21
V. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT	23
VI. VIZIONI DREJT PROJEKTEVE	25
VII. AMËZA E PROJEKTEVE NË RAPORT ME SYNIMET	31
VIII. PLANI IMPLEMENTUES I PROJEKTEVE TË ZHEL-it	35
PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE	39
Aneksi 1. Grupet Punuese Komunale	82
Aneksi 2. Grupi i Palëve të Interesuara	83

HYRJE

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal e komunës së Lipjanit 2005-2007” ka rezultuar nga Projekti DELTA II. Komuna e Lipjanit është zgjedhur në këtë projekt së bashku me katër komuna të tjera të Kosovës¹.

DELTA II është bashkëfinancuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI) në Budapest, përderisa vetë komunat pjesëmarrëse në projekt dhe “Friedrich Ebert Stiftung” (FES) kanë kontribuar financiarisht në një masë më të vogël. Banka Botërore nga Uashingtoni mbështeti projektin duke i ofruar asistencë teknike. Projekti është implementuar nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore “Rinvest”, në Prishtinë. Synimi i projektit ishte “aftësimi i komunave në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillim të NVM (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme)”. Përveç synimit, DELTA II ka patur edhe disa objektiva, si forcimi i kapaciteteve të administratës komunale për të hartuar dhe implementuar Strategjitë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL), mbështetja e komunave në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e NVM-ve dhe forcimi i partneritetit ndërmjet qeverisë komunale, komunitetit biznesor dhe shoqërisë civile.

Strategjia përmban Vizionin, Synimet, Objektivat, Programet dhe Projektet, të cilat janë të lidhura dhe të harmonizuara me njëra-tjetrën. Strategjia do të konsiderohet si bazë për Qeverinë Komunale të Lipjanit për periudhën e ardhshme trevjeçare 2005-2007.

Si është hartuar Strategjia? Në fillim të procesit për hartimin e strategjisë janë formuar Ekipi Komunal për ZHEL dhe Grupi Punues, si dhe është themeluar Forumi i Palëve të Interesuara. Ekipi për ZHEL dhe Grupi Punues kanë marrë mbështetje politike nga udhëheqësit komunalë. Gjatë hartimit të strategjisë janë

¹ Pesë komunat pjesëmarrëse në projektin DELTA II janë: Gjilani, Peja, Ferizaj, Drenasi (ish-Glllogoci) dhe Lipjani.

organizuar katër punëtori (workshops), në të cilat Ekipi për ZHEL i komunës së Lipjanit ka marrë pjesë aktive. Punëtoritë janë ndarë në orë teorike dhe praktike dhe i tërë procesi është ndihmuar nga Ekipi Menaxhues i projektit DELTA II nga “Riinvest”-i, por gjithashtu edhe nga ekspertët vendorë nga “Riinvest”-i dhe konsulentët ndërkombëtarë. Pas çdo punëtorie janë përgatitur planveprimet, të cilat kanë shërbyer si udhërrëfyes për Ekipin Komunal të ZHEL-it, për të zhvilluar aktivitetet hartuese strategjike. Ekipi Komunal, në bashkëpunim me Grupin Punues dhe i mbështetur nga palët e interesuara komunale, ka punuar në grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave dhe definimin e Vizionit, Synimeve, Objektivave, Programeve dhe Projekteve.

Gjithashtu, Ekipi Komunal për ZHEL mori pjesë në vizitën studiuase në Slloveni, nga 26 shtatori deri më 2 tetor 2004, në të cilën u informua lidhur me përvojat sllovene në fushën e ZHEL-it, administratën lokale, hartimin e strategjive zhvillimore, zonat biznesore, inkubatorët biznesorë në Slloveni, etj.

I. ORGANIZIMI I PËRPPJEKJEVE

Në komunën e Lipjanit, në fillim të procesit strategjik, pas marrjes së mbështetjes politike nga kryetari Xhevat Olluri dhe kryeshefi ekzekutiv Imri Ahmeti, është formuar ekipi i ngushtë - Ekipi Komunal për ZHEL, i cili është përbërë nga pesë anëtarë - katër prej tyre nga stafi i administratës komunale, kurse një nga komunitetit i biznesit. Roli i tij ka qenë të koordinohen të gjitha aktivitetet e procesit për hartim të strategjisë.

Anëtarët e Ekipit për ZHEL të komunës së Lipjanit:

1. Rexhep Rudari – Drejtor Komunal për Ekonomi dhe Zhvillim – Udhëheqës i Ekipit;
2. Sherif Bytyqi – Shef i Sektorit Komunal për Ekonomi;
3. Hanushe Berisha – Zyrtare në Drejtoratin Komunal për Urbanizëm;
4. Shaban Sylja – Drejtor Komunal për Buxhet dhe Financa, dhe
5. Smajl Shabani – Përfaqësues biznesi.

Përveç ekipit të ZHEL-it, gjithashtu janë formuar Grupet Punuese Komunale, të përbëra nga Drejtoritë Komunale. Këto grupe kanë pasur rolin teknik profesional dhe kanë përkrahur Ekipin Komunal gjatë tërë ciklit të projektit, kanë ndihmuar me të dhëna, propozime, sugjerime, udhëzime e këshillime mjaft konstruktive.

Grupet Punuese Komunale(shih Aneksin 1):

1. Grupi për planifikim dhe shërbime publike
2. Grupi për bujqësi dhe pylltari
3. Grupi për ekonomi dhe biznes
4. Grupi për arsim, shendetësi, rini, kulturë dhe sport.

Përveç grupeve punuese komunale, në Maj 2004 u formua edhe Forumi i Palëve të Interesuara. Anëtarë të këtij Forumi ishin palë të ndryshme të interesuara komunale si përfaqësues të qeverisë komunale, komunitetit të biznesit dhe të

shoqërisë civile (shih Aneksin 2). Forumi kontribuoi me sygjerrime dhe analiza të fazave të ndryshme të hartimit të strategjisë. Forumi i Palëve të Interesuara u takua katër here gjatë procesit strategjik, zakonisht në fund të çdo plan veprimi.

Hierarkia organizative për hartimin e strategjisë së ZHEL-it


Struktura organizative komunale përbëhet prej Kuvendit Komunal, Komiteteve të Kuvendit dhe 12 departamenteve të Qeverisë Komunale. Kuvendi i komunës përbëhet nga 31 këshilltarë.

Skema e paraqitur më poshtë tregon se Ekipi Komunal ka patur mbështetje politike për hartimin e strategjisë nga kryetari i Kuvendit Komunal të Lipjanit, Xhevat Olluri. Gjithashtu, edhe nga Kryeshefi Ekzekutiv, Imri Ahmeti, i cili, përveç mbështetjes politike, Ekipit Komunal i ka ofruar edhe përkrahje administrative dhe profesionale, nëpërmjet drejtorive qeveritare komunale.

Komuna e Lipjanit qeveriset sipas Rregullores së UNMIK 2000/45, e cila qartazi definon përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë. Mirëpo, ekzistojnë disa ligje dhe rregullore të tjera, që janë miratuar nga pushteti qendror, të cilat krijojnë konflikt interesash ndërmjet komunës dhe qeverisë qendrore në fushën e shërbimeve të kompanive publike, shërbimit civil të Kosovës, arsimit fillor dhe atij të mesëm, menaxhimit të tokës komunale dhe/ose shoqërore. Problemi i tokës ka të bëjë me faktin se në të kaluarën, në shumë raste, dallimi ndërmjet tokës në pronësi komunale dhe shoqërore nuk ka qenë i qartë.

Përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë, sipas Rregullores së UNMIK 2000/45 janë:

- Sigurimi i kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Planifikimi urban dhe rural dhe shfrytëzimi i tokës;
- Licencimi i ndërtimeve dhe zhvillimeve të tjera;
- Mbrojtja e ambientit lokal;
- Implementimi i rregulloreve për ndërtim dhe standardeve për kontroll të ndërtimit;
- Sigurimi i shërbimeve lokale publike dhe infrastrukturës, duke përfshirë edhe furnizimin me ujë, kanalizimet dhe drenazhet, trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave, rrugëve lokale, transporti lokal dhe skema për nxemje lokale;
- Shërbimet publike, duke përfshirë edhe zjarrfikjen dhe shërbimet emergjente;
- Menaxhimi i pronës komunale;
- Arsimi parafillor, fillor dhe i mesëm;



- Përkujdesja primare shëndetësore;
- Shërbimet sociale dhe të banimit;
- Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndeti publik;
- Licencimi i shërbimeve, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, transportin lokal publik dhe taksitë, gjuetinë dhe peshkatarinë, si dhe restorantet dhe hotelet;
- Panairët dhe tregjet;
- Emërimi dhe riemërimi i rrugëve, lagjeve dhe vendeve të tjera publike;
- Sigurimi dhe mirëmbajtja e parqeve publike, shesheve dhe varrezave;
- Aktivitetet tjera që janë të domosdoshme për administrim adekuat të komunës dhe të cilat nuk janë përcaktuar me ligj.

Struktura e Buxhetit Komunal

Buxheti komunal sigurohet nga dy burime: a) granti nga qeveria qendrore dhe b) të hyrat vetanake komunale. Në tabelën1 mund të shihet struktura e buxhetit të paraparë për periudhën 2004-2006, sipas kategorive shpenzuese. Shihet qartë se pjesa më e madhe e buxhetit të vitit 2004 është planifikuar të shpenzohet për paga dhe mëditje 66.6%, për mallra dhe shërbime 20.4%, dhe për shpenzime

Table 1. Buxheti i planifikuar i të hyrave vetanake për vitet 2004-2006 sipas kategorive shpenzuese

Nr.	Kategoritë e Shpenzimeve	2004	%	2005	%	2006	%
1	Paga dhe mëditje	3,701,207.58	66.59	3,710,207.64	7.40	3,701,207.64	67.22
2	Mallra dhe shërbime	1,135,853.96	20.43	1,092,857.26	19.85	1,102,918.38	20.03
3	Shpenzimet kapitale	721,431.00	12.98	701,607.50	12.75	701,680.00	12.74
	Gjithsejt	5,558,492.54	100	5,504,672.40	100	5,505,806.02	100

Burimi: Drejtorja e Ekonomisë, Lipjan, 2004

kapitale vetëm 13% e buxhetit.

Pjesëmarrja tepër e ulët e shpenzimeve kapitale (13%) në buxhetin e tërësishëm për 2004 në komunën e Lipjanit nuk përputhet as për së afërmi me kërkesat për investime në infrastrukturë gjatë tërë kësaj periudhe. Situatë e njejtë do të pasojë

edhe gjatë viteve 2005 dhe 2006. Sa i përket granteve nga qeveria qendrore, ato shpenzohen kryesisht në arsimin e mesëm dhe atë fillor, si dhe në shëndetësinë primare.

II. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Historiku

Lipjani njihet si vendbanim që nga periudha Romake. Qytet me rëndësi dhe kryqëzim i rrugëve ishte Ulpiana, e cila ndodhej në verilindje, në largësi 10 km nga Lipjani i sotëm. Në periudhën romake ishte kryesisht një vendbanim i vogël në rrugën për në Lissum. Identifikimi i Lipjanit me emrin Ulpiana më vonë është vërtetuar edhe me zbulimet e gërmadhave të vendbanimeve të antikës së vjetër dhe të Periudhës së Bizantit.

Lipjani gjendet në pjesën qendrore të Kosovës. Kufizohet nga veriu dhe verilindja me komunën e Prishtinës, nga veriperëndimi me Fushë-Kosovën, nga perëndimi me Drenasin dhe Malishevën, në jugperëndim me Shtimjen, nga jugu me Ferizajin, kurse në lindje me Gjilanin dhe Artanën (ish-Novobërda). Komuna e Lipjanit gjendet në udhëkryqin e magjistrales Prishtinë-Shkup në gjatësi 14.5 km dhe në magjistralen Prishtinë-Prizren në gjatësi prej 13 km. Lipjani është 15 km. larg nga kryeqendra (Prishtina). Në terriorin e kësaj komune gjendet aeroporti i vetëm i Kosovës. Lipjani ka klimë të mesme kontinentale, me dimra relativisht të butë dhe vera mesatarisht të nxehta.

Popullata

Në komunën e Lipjanit, përveç shqiptarëve si shumicë, jetojnë edhe komunitete të tjera, siç janë: serbët, kroatët, ashkalinjtë, romët etj. Në qoftë se nisemi nga të dhënat e regjistrimit të fundit të popullatës në vitin 1981² dhe, nëse e marrim normën e shtimit natyror për 2%, atëherë numri i banorëve në komunën e

² Regjistrimi i fundit i populates në Kosovë, për shkak të okupimit të Kosovës nga Serbia.



Lipjanit në vitin 2004 do të ishte **87.660** banorë. Në tabelën 2 mund të shihen vlerësimet për moshën e popullsisë sipas grup-moshave për vitin 2004.

Tabela 2. Moshë e popullsisë sipas grup-moshave për vitin 2004

Popullsia më 2004	0-14 vjet	%	15-34 vjet	%	35-54 vjet	%	55-75 e më shumë	%
87660	36582	41,73	29054	33,17	14289	16,3	7735	8,82

Burimi: Komuna e Lipjanit, 2004

Nga tabela 2 shihet se struktura moshore prej 0-54 vjeçare është mbi mesataren nacionale të vendit, strukturë që është mjaft inkurajuese për zhvillimin e mëtejshëm të komunës. Shikuar sipas ecurive të shtimit natyror të popullatës, supozohet se ky shtim ka tendencë të rënies.

Papunësia dhe gjendja sociale

Papunësia - Sipas të dhënave të Qendrës për Punësim, deri në fund të dhjetorit 2004, në këtë qendër janë lajmëruar rreth 9884 të punëkërkuar (shih tabelën 3).

Table 3. Numri i të punëkërkuarve të regjistruar sipas kualifikimit dhe gjinisë

Nr.	Kualifikimi	Numri i përgjithshëm	Femra	Meshkuj
1	Të pakualifikuar	4333	1964	2369
2	Gjysmë të kualifikuar	42	3	39
3	Të kualifikuar	696	231	465
4	Me shkollë të mesme	4795	1876	2919
5	Me shkollë të lartë	5	2	3
6	Me fakultet	13	2	11
	Gjithsej:	9884	4078	5806

Burimi: Drejtoria e Ekonomisë, Lipjan, 2003

Duke iu referuar këtyre të dhënave del se prej numri i të punësuarve të regjistruar 4,759 janë me shkollë të mesme, ndërsa 4,333 të pakualifikuar. Megjithatë, këto të dhëna nuk janë reale, duke marrë parasysh se një pjesë e madhe e të papunëve nuk janë të paraqitur në Qendrën e Punësimit. Megjithatë, vlerësohet se edhe në komunën e Lipjanit papunësia sillet në mesataren e vendit prej rreth 50%.

Punësimi – Të dhënat nga Tabela 4 në lidhje me punësimin sipas veprimtarive, sugjerojnë që industria përpunuese punëson pjesën më të madhe të punëtorëve (rreth 32%), pas saj vjen tregtia me mbi 29%. Numri total i të punësuarve në aktivitetet e sipërpërmendura vlerësohet të jetë rreth 6662, siç është paraqitur në Tabelën 4. Numri zyrtar i të punësuarve mund të jetë më i lartë, mirëpo, një numër i punëtorëve nuk paraqitet në mënyrë të rregullt nga punëdhënësit e tyre me qëllim të evitimit të pagesës së tatimeve dhe kontributeve.

Tabela 4. Numri i ndërmarrjeve dhe i të punësuarve sipas veprimtarisë

Nr.	Veprimtaria	Numri i të punësuarëve	
		Numri	(%)
1	Bujqësia, pylltaria, peshkataria	385	5.78
2	Industria e minierave dhe ekstraktuese	37	0.56
3	Industria përpunuese	2136	32.06
4	Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë	38	0.57
5	Ndërtimtaria	818	12.28

6	Tregtia	1975	29.65
7	Hotelet dhe restorantet	335	5.03
8	Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	621	9.32
9	Ndërmjetësimi financiar	6	0.09
10	Afarizmi me pasuri të patundshme	59	0.89
11	Arsim (Autoshkolla etj.)	71	1.07
12	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	49	0.74
13	Të tjera	132	1.98
	Gjithsej	6662	100

Burimi: Drejtoria e Ekonomisë, Lipjan, 2003

Gjendja sociale - Si pasojë e okupimit gati dhjetëvjeçar, komuna e Lipjanit, si edhe komunat tjera kosovare, pësoi humbje nga më të ndryshmet, si shkatërrimi i shumë shtëpive (mbi 1792), vjedhja dhe dëmtimi i shumë ndërmarrjeve ekonomike, si dhe shkatërrimi i fondit blegtoral dhe dëmtimi i makinerisë bujqësore, etj. Këta ishin ndër faktorët më kryesorë që ndikuan në varfërimin e popullatës. Sipas të dhënave të Qendrës për Mirëqenie Sociale në Lipjan (shih tabelën 5), numri i personave apo familjeve që marrin ndihma sociale në vitin 2004 është 1466, një zvogëlim prej 37 nga viti 2003.

Table 5. Numri i familjeve me ndihma sociale sipas viteve dhe nacionalitetit

Nr.	Viti	Numri i familjeve	M	F	Refugjatë	Sërb	Ashkalinjë	Kroatë
1	2000	1238	985	253	/	273	78	35
2	2001	1498	1187	311	7	247	81	49
3	2002	1369	1089	280	3	215	95	32
4	2003	1503	1194	309	/	219	154	24
5	2004	1466	1180	281	/	214	170	17

Burimi: Qendra për Mirëqenie Sociale, Lipjan, 2004

Arsimi

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Lipjanit zhvillohet në 19 shkolla fillore amë dhe në 42 paralele të ndara fizike. Kurse, shkollimi i mesëm zhvillohet në 3 shkolla amë dhe në 3 paralele të ndara. Numri i gjithmbarshëm i punonjësve arsimorë në shkollat fillore dhe të mesme në vitin 2003-2004 është 1099. Sa i përket gjendjes me kuadro, ekziston një deficit në profesionet e elektroteknikës, makinerisë, informatikës, matematikës, gjuhëve të huaja etj. Shkolla e mesme është e ndarë në: (I) Gjimnaz dhe në (II) Shkollën e Degëve Profesionale, si dega e Makinerisë, e Elektroteknikës, Informatikës, Ekonomisë, etj.

Në shkollën e mesme profesionale “Adem Gllavica” ekziston qendra e trajnimit nga OJQ “Norges Vel”. Aktivitetet kryesore me të cilat merret kjo shoqatë janë:

- § Dhënia e ndihmës materiale dhe financiare për shkollën bujqësore;
- § Dhënia e këshillave dhe sugjerimeve nga ekspertët norvegjezë;
- § Ndihma profesionale në përgatitjen e planeve të punës, dhe
- § Organizimi i kurseve të ndryshme trajnuese dhe aftësuese për moshën e të rriturve mbi 18 vjeç, e të tjera

Ekonomia

Ambienti biznesor - Territorin e komunës së Lipjanit e karakterizojnë pasuritë e begatshme tokësore dhe nëntokësore, pozita mjaft e volitshme gjeografike dhe fuqia e re punëtore, të cilat kanë qenë dhe janë bazë e fortë për një zhvillim te suksesshëm ekonomik. Ekonomia e Lipjanit deri në vitet e 70-ta karakterizohet kryesisht me eksploatimin e lëndëve të para si dhe me kultivimin e prodhimeve primare bujqësore. Pas viteve të 70-ta kemi investimet dhe ngritjen e objekteve prodhuese, përpunuese dhe industriale si: MIM “Goleshi”, Fabrika e Letrës dhe Kartuçit, shkretorja dhe fonderia e metaleve të ngjyrosura “Metal Holding Kompany”, Fabrika e “Coca Colës”, Miniera e thëngjillit - Babush i Muhaxherëve, Separacioni dhe gurthyesit në Babush, Termoventi, Shpezëtaria, Kooperativa Bujqësore me njësitë e saj etj. Pas vitit ‘99 janë ngritur edhe disa fabrika, por kryesisht në sektorin privat, si “Bonusi” për prodhimin e ujit, “Dajti” për prodhimin e detergjentit, “Xella” për prodhimin e tullave silikate etj.

Shikuar për nga numri i degëve të cilat kanë ekzistuar, shihet se ekonomia e Lipjanit ishte një ekonomi e pasur industriale. Që nga vitet e ’90-ta ekonomia ka pësuar një rënie të madhe prej viti në vit, si në aspektin teknologjik, financiar dhe në atë tregtar. Pas luftës gati i tërë potenciali industrial është shkatërruar dhe nuk funksionon.

MIM “Goleshi” ishte shtylla kryesore e zhvillimit industrial. Punësonte 1200 punëtorë dhe kishte një kapacitet mbi 120.000 tonë xehe të magnezitit dhe 20.000 të dunitit në vit. Xehja e magnezitit me produktet e saj të sinter-magnezitit dhe kaustikut ishin shumë të kërkuara në tregjet e ish-Jugosllavisë dhe në tregjet e jashtme.

Ndërmarrja shoqërore “Metali”, e cila kishte mbi 700 të punësuar dhe me një traditë të pasur për shkrirjet e metaleve të ngjyrosura, bënte shkrirje dhe kallupime të elementeve të ndryshme, qoftë në prodhimin individual apo në atë serik. Edhe kjo industri pas luftës është në gjendje jo të mirë.

Mbushtorja e pijeve joalkoholike “Coca Cola”ka qenë shumë e suksesëshme në rajon , të punësuar mbi 100 punëtor Sot kjo ndermarrje është e privatizuar. Blerësi i fabrikës është firma “Frut-Ag” nga Prishtina.

Sipas rezultateve të anketës së realizuar nga Instituti “Riinvest” me menaxherët e disa bizneseve, bashkëpunimi midis komunitetit të biznesit dhe komunës është në nivel jo aq të kënaqshëm, duke u zhvilluar më shumë nëpërmjet kontakteve administrative. Në komunën e Lipjanit niveli i organizimit të bizneseve nuk është i kënaqshëm. Për momentin vepron vetëm shoqata e bletarëve dhe ajo e gjuetarëve, kurse pjesëmarrja e bizneseve në Odën Ekonomike është shumë e vogël. Me kalimin e regjistrimeve të bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, është vështirësuar mbajtja e evidencës për bizneset, si regjistrimi, numri i punëtorëve, etj. Strukturat komunale në terren ballafaqohen me biznese ilegale, të cilat shkaktojnë konkurrencë jolojale.

Struktura biznesore - Sipas të dhënave nga muaji maj 2003 numri i bizneseve të regjistruara ka qenë 1795, në të dy sektorët, në sektorin shoqëror 36 ndërmarrje, kurse në atë privat 1759. Kurse numri i bizneseve që operojnë të peregjistruara ishte 1577. Tabela 6 tregon pjesëmarrjen në përqindje të numrit të ndërmarrjeve në totalin e bizneseve sipas veprimtarisë, ku mund të shihet një strukturë e pavolitshme e bizneseve, pasi që rreth 48% e bizneseve i përkasin tregtisë, ndërsa prodhimit vetëm rreth 9%.

Table 6. Pjesëmarrja në përqindje e bizneseve sipas veprimtarive

Bizneset sipas veprimtarive	%
Tregtia	47.8
Transporti	17.6
Prodhimi	8.7
Ndërtimtaria	8.5
Hotelieria	7.0
Të tjera	10.4
Gjithsej	100

Burimi: Drejtoria e Ekonomisë, Lipjan, 2003

Bujqësia - Komuna e Lipjanit është trevë kryesisht bujqësore. Toka është e cilësisë së lartë, klima është mjaft e përshtatshme, temperatura mesatare vjetore është 10⁰ C. Komuna disponon me sipërfaqe të tokës së përgjithshme 40. 072, 12 ha. Prej kësaj sipërfaqeje 24. 674, 28 ha janë tokë e punueshme apo 62 % të sipërfaqes së përgjithshme, ndërsa pyje janë 12. 952, 48 ha. Sa i përket finalizimit të prodhimeve primare bujqësore, sektori privat ka shënuar një zhvillim në ngritjen e mullijve, të cilët në komunën tonë janë 7 dhe një në sektorin shtetëror. Prej kulturave lavërtare më së tepërmi kultivohen: gruri, misri, elbi, tërshëra, panxharsheqeri, luledielli, kolza, derisa kohëve të fundit po kultivohet edhe soja. Prej pemëve më së tepërmi kultivohen: molla, dardha,

kumbulla, ftoi. Ekzistojnë kushte të përshtatshme edhe për kultivimin e manaferrës, mjedrës, lajthisë, rrush, bimëve mjekuese etj.

Prej perimeve më së tepërmi kultivohen patatja, speci, domatja, trangulli, preshi, shalqini, pjepri etj.

Sa i përket *blegtorisë*, gjendja e saj ka filluar të përmirësohet pas dëmtimeve nga lufta. Falë donacioneve ndërkombëtare dhe investimeve vetanake të fermerëve, ekzistojnë dy ferma të mëdha të lopëve qumështore, njëra me kapacitet 200 krerë e tjetra 50 krerë, si dhe një qumështore, “Diti”, me një kapacitet prej 500 litra qumësht në ditë. Në lëmin e *shpendëtarisë* funksionon një fermë e pulave vojse, në pronësi shoqërore, me një kapacitet prej 500.000 pulash, e cila tani është e komercializuar dhe punon vetëm me 50 % të kapacitetit. Komuna e Lipjanit ka traditë në kultivimin e peshkut, të cilin kultivim e ka bërë në hurdhën e peshqve në fshatin Radevë, në një sipërfaqe mbi 70 ha. Prej llojit të peshqve kultivohet krapu, balgjeri dhe amuri. Tani edhe kjo hurdhë është e komercializuar dhe shfrytëzohet shumë pak. Pas luftës kemi edhe kultivimin e troftës në sektorin privat, në fshatin Bincë.

Pyjet: Pyjet në komunën e Lipjanit përfshijnë një sipërfaqe prej 12.952.48 ha në të dy sektorët. Këto sipërfaqe janë të mbuluara me drunjtë të ndryshëm si: ahu, qarri, bingu, shkoza, frashëri, bliri, pisha etj. Në mesin e këtyre maleve gjendet edhe Blinaja, ku ka një sipërfaqe prej 3000 ha të rrethuar, sipërfaqe e cila ka qenë si rezervat i rritjes së shtazëve të egra dhe vend për gjah. Pas djegies së 150 ha me pishë në Gadime, është bërë ripyllëzimi i kësaj sipërfaqeje të djegur me rreth 50 ha deri në vitin 2004. Qeveria komunale ka në plan të ripyllëzojë në vitin 2005 10 deri 15 ha me pisha.

Turizmi: Ekzistojnë kushte natyrore mjaft të volitshme, me bukuritë dhe rrallësitë e tyre, që bëjnë të mundshëm zhvillimin e turizmit në këto treva.

Shpella e Mermertë, e formuar prej mermerëve dhe gurëve gëlqerorë, stalagmiteve dhe stalaktiteve të formacioneve poleozolit, me një temperaturë konstante rreth 15 C, pa marrë parasysh ndryshimet stinore, është një objekt nëntokësor mjaft interesant dhe atraktiv për vizitorët e jashtëm dhe të brendshëm. Ndërtimi i rrugës Gadime-Gjilan krijon mundësi për zhvillimin e turizmit malor në këto anë.

Blinaja është park nacional, i cili ka mbi 3000 ha të rrethuara, me një florë dhe faunë shumë të pasur dhe kurorat e drunjve të larta dhe të dendura. Mëse 33 liqejt natyrorë dhe 60 livadhet, prezenca e shumë shtazëve të egra, si dreri, kaprolli, derri i egër, mufloni, macja e egër, lepuri, ujku, dhëlpëra etj., si dhe shumë shpezë, e bëjnë këtë vend atraktiv. Vetë kushtet natyrore në Blinajë mundësojnë një regjenerim të botës bimore dhe shtazore mjaft të përshtatshëm dhe mundësi për një rezervat gjutie dhe rekreacion për shumë vizitorë.



Infrastruktura

Uji dhe kanalizimi – Mbi 70% e banorëve të qytetit të Lipjanit janë të lidhur me ujësjellësin dhe mbi 50% me rrjetin e kanalizimit. Amvisëritë dhe ndërrmarjet industriale furnizohen me ujë nga puset. Një pjesë e fshatrave të komunës, ku përfshihen rreth 30 % të popullatës, janë të furnizuara me ujë të pijshëm nga ujësjellësi. Sistemi i kanalizimit është në gjendje të dobët dhe nuk funksionon si duhet. Shumë nga vendbanimet nuk kanë sistem të kanalizimit, vetëm 10 % e fshatrave janë të lidhura me rrjetin e kanalizimit dhe kjo shkakton ndotjen e ujit të pijshëm.

Rryma elektrike - Për shkak të ndërtimit relativisht të hershëm të rrjetit elektrik, tani kur nevojat për energji elektrike janë shumëfishuar, shumica e venbanimeve nuk kanë furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike. Prandaj, ndihet nevoja për riparimin dhe ndërrimin e rrjetit në tërësi, si dhe transformatorëve, të cilët nuk i plotësojnë kushtet për furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike.

Rrugët dhe transporti. Rrugët e asfaltuara në komunë kanë gjatësi prej 90 km, kurse rrugët e rendit të katërt në komunën e Lipjanit janë 122 km, ndërsa rrugë të shtruara me gurë, por të pakategorizuara, kanë gjatësinë prej 207 km. Hekurudha kalon përmes komunës së Lipjanit, me gjatësi prej 13 km, me 3 stacione. Hekurudha është e përdorshme, pasi që vija kryesore është e riparuar nga KFOR-i, ndërsa binarët përcjellës, të cilët shërbejnë për ngarkim-shkarkim të mallrave, kanë nevojë për riparim, kurse vendparkingu duhet asfaltuar. Ky lloj transporti përdoret shumë pak nga qytetarët.

III. ANALIZA KONKURRUESE (SWOT)

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> Ü Pozitë strategjike në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme (trekëndëshi Lipjan-Durrës, Lipjan-Selanik dhe Lipjan -Prishtinë (Larg nga aeroporti i Prishtinës vetëm 15 km). Ü Zbatimi i një programi për arsimimin profesional plotësues (në bujq. informat. gjuhë të huaja, etj.) - nga OJQ "Norges Vel" Ü Qasje e lehtë në sigurimin e lokacioneve për sektorin e bizneseve të NVM-ve dhe banimit individual Ü Kushte të përshtatshme për mbrojtjen e mjedisit Ü Ekzistimi i mineraleve si nikel, magnezit, dunit, lignit, rërë kuarci, guri gëlqeror, etj. Ü Kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit (Shpella e Mermerit, Blinaja, ujërat termike, etj.) Ü Kushtet gjeografike, klimatike dhe uji i mjaftueshëm për zhvillimin e blegtorisë dhe bujqësisë Ü Fermerë me traditë për zhvillimin e agrobizneseve 	<ul style="list-style-type: none"> Ü Buxheti i vogël komunal (arsim, kulturë, shëndetësi, etj) Ü Fonde të varfëra për përkrahjen e NVM dhe masave stimulative për bujq Ü Mospërbatimi i rregulloreve dhe ligjit për mbrojtjen e ambientit Ü Mungesa e planit hapësinor dhe urbanistik Ü Infrastruktura e dobët në viset rurale Ü Mungesa e shoqatave të biznesit Ü Mosekzistimi i një zone zejtare-industri e lehtë Ü Niveli jo mjaft i zhvilluar i bashkëpunimit ndërmjet komunitetit të biznesit dhe qeverisë lokale Ü Rezistenca ndaj ndryshimeve në reformat në arsim (konflikti i gjeneratave) Ü Mospërfshirja e mjaftueshme e femrës në punësim Ü Shkalla e ulët e arkëtimit të taksave, ngarkesave dhe tatimit në pronë
Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> Ü Bartja e kompetencave tek vendorët/niveli lokal Ü Kthimi i pronave të komunës nga AKM Ü Privatizimi i një numri të ndërmarrjeve shoqërore Ü Rritja e ndarjeve nga buxheti për infrastrukturë Ü Përmirësimi i kushteve kreditore Ü Hartimi dhe aprovimi i ligjit për administrim lokal Ü Mundësitë reale për rritjen e peshkut Ü Rritja e interesimit të kompanive të huaja për investime në sektorin privat Ü Shfrytëzimi më i mirë i kapaciteteve ekzistuese të mullinjve të grurit Ü Prodhimi i ushqimit të kafshëve Ü Riaktivizimi i minierave të magnezitit dhe nikelit Ü Komercioni i tokave dhe melorimi i tokave 	<ul style="list-style-type: none"> Ü Vonesa e reformave në arsim Ü Vazhdimi i procesit të ngadalshëm të privatizimit, shkatërrimi dhe demolimi i NSH Ü Jostabiliteti social dhe politik Ü Statusi i padefinuar politik i Kosovës Ü Infrastruktura e pamjaftueshme ligjore në nivel komunal dhe kombëtar Ü Imtësimi i parcelave të tokës Ü Konkurrenca jolojale ndaj prodhuesve lokalë Ü Kompetencat e paqarta në mes nivelit lokal dhe atij qendror në fushën e ZHEL-it

IV. VIZIONI

Lipjani do të jetë komunë me zhvillim të lartë ekonomik, industrial, turistik dhe ekologjik, sipas standardeve bashkëkohore, duke siguruar kushte tërheqëse për jetesë dhe për investime në biznese. Do të bëhet qendër e fuqishme industriale dhe biznesore për rajonin, me fermerë modernë dhe sektor të fortë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

V. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT

S1. Sigurimi i infrastrukturës së rëndë dhe të butë në funksion të krijimit të mjedisit të pastër ambiental, të zhvillimit ekonomik lokal sipas planit adekuat hapësinor dhe në pajtim me kërkesat e kohës.

- S1-O1:** Hartimi dhe aprovimi i planit strategjik zhvillimor urban të komunës deri në Maj 2005.
- S1-O2:** Përmirësimi për 30% i transportit rrugor në pjesët urbane dhe rurale, furnizimit me ujë, kanalizimit dhe pajisjet për ndotësit e ambientit deri më 2006.
- S1-O3:** Përgaditja dhe zbatimi i planit për modernizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në qytetin e Lipjanit dhe definimi i lokacioneve në zonat rurale deri më 2007.

S2. Ngritja e kapaciteteve të administratës lokale për ofrimin e shërbimeve profesionale dhe të favorshme për komunitetin e biznesit.

- S2-O1:** Të mundësohet formimi i bordit të ekspertëve, të cilët do të jenë në shërbim të zhvillimit të komunitetit të bizneseve dhe qytetarëve me shërbime dhe ide profesionale, kështu që në fund të vitit 2005 60 % e NVM të jenë të kënaqura me këto shërbime.
- S2-O2:** Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e strategjisë nëpërmjet trajnimit të stafit kyç të departamenteve deri në 20% deri në fund të vitit 2005.
- S2-O3:** Të hartohet një plan veprues i cili do të ndikojë në përmirësimin e inkasimit të tatimeve komunale me qëllim të favorizimit të NVM.
- S2-O4:** Bashkëpunimi i qeverisë lokale me partnerët afaristë për ngritjen e cilësisë profesionale veçmas në lëmi të caktuara si informatikë, administratë, statistikë, kontabilitet, marketing, etj., nga institucione profesionale për ngritjen e profesionalizmit deri në 2007 rreth 90 % e stafit të trajnuar.

S3. Përmirësimi i pozitës së qytetarit me mundësi të barabarta të trajnimit dhe punësimit.

S3-01: Të bëhet trajnimi i një numri të konsideruar të femrave dhe formimi i pesë ekipeve profesionale për të ofruar shërbime në edukimin shëndetësor për komunitete.

S3-02: Rikualifikimi deri në 20% të femrave në viset rurale me qëllim të përmirësimit të pozitës së saj në punësim gjatë viteve 2005-2007, (sera, miniferma, artizanate, servise, etj).

S4. Krijimi i kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve nga sektori privat vendor dhe i huaj.

S4-01: Që nga fundi i vitit 2005 qeveria lokale të krijoj mundësi reale për mbështetje të zhvillimit të hovshëm të ndërmarrjeve prodhuese numri i të cilave do të rritet deri në 20 % në krahasim me një vit më parë.

S4-02: Ngritja e infrastrukturës së përshtatshme për zhvillimin e turizmit si Shpella e Mermerit, Parku Nacional Blinaja, uji termik në Bainsë, deri më 2007.

S4-03: Hulumtimi i potencialeve minerale tokësore, nëntokësore dhe bujqësore dhe mundësitë për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tyre deri në fund të vitit 2006.

S4-04: Deri më 2007 rreth 60 % e ndërmarrjeve të jenë të përfshira në asociacione të ndryshme biznesore.

S4-05: Deri në shtator të 2007 komuna do të siguroj qasje të lehtë për biznese në zonën industriale.

S5. Të avancohet sistemi i arsimit dhe shëndetësisë, me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor të popullatës.

S5-01: Të reformohet profili arsimor deri në fund të periudhës 2007 nga i cili do të sigurojmë dhe aftësojmë kuadro për nevojat e ekonomisë komunale sipas kërkesave të ekonomisë së tregut.

S5-02: Rritja e hapësirës shkollore në viset rurale deri më 2005/06.

S5-03: Rritja e shërbimeve shëndetsore primare në zonat rurale deri në vitin 2007.

VI. NGA VIZIONI DREJT PROJEKTEVE

Vizioni	Synimet	Objektivat	Programet	Projektet
<p>Lipjani do të jetë komunë me zhvillim të lartë ekonomik, industrial, turistik dhe ekologjik sipas standardeve bashkëkohore duke siguruar kushte tërheqëse për jetesë dhe për investime në biznese. Do të bëhet qendër e fuqishme industriale dhe biznesore për rajonin, me fermerë modernë dhe sektorë të fortë të ndërmarrjeve të vogla e të mesme</p>	<p>S1: Sigurimi i infrastrukturës fizike dhe institucionale në funksion të krijimit të mjedisit të pastërt ambiental, të zhvillimit ekonomik lokal sipas planit adekuat hapsinor dhe në pajtim me kërkesat e kohës</p>	<p>S1-O1: Hartimi dhe aprovimi i planit strategjik zhvillimor urban të komunës deri në Maj 2005</p>	<p>S1-O1-Pg1: Përmirësimi i kushteve urbanistike në territorin e Komunës. Sistemi i urbanizimit me përcaktimin e konceptit, veprimtaria në hapsirën e komunës, destinimi i sipërfaqeve urbane, revitalizimi i fondit banesor dhe sanimi i sipërfaqeve urbane të degraduara</p>	<p>S1-O1-Pg1-Pr1: Hartimi dhe aprovimi i planit strategjik zhvillimor të komunës deri në muajin Maj 2005. S1-O1-Pg1-Pr2: Sigurimi (Inçizimi) i kadastrit nëntokësor për qytetin e Lipjanit S1-O1-Pg1-Pr3: Studimi paraprak, implementimi dhe ndërtimi i bllokut banesor për nevoja të banimit kolektiv në qytetin e Lipjanit</p>
		<p>S1-O1-Pg2: Programi për përmirësimin e infrastrukturës ligjore</p>	<p>S1-O1-Pg2-Pr1: Krijimi i një baze të të dhënave për pronën publike, komunale dhe hapsirave industriale</p>	
		<p>S1-O2: Përmirësimi për 30% i transportit rrugor në pjesët urbane dhe rurale, furnizimi me ujë, kanalizimit dhe pajisjet për ndotësit e ambientit deri më 2006</p>	<p>S1-O2-Pg1: Programi për përmirësimin e infrastrukturës së rëndë</p>	<p>S1-O2-Pg1-Pr1: Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për lagjet: Rupçina 1 dhe 2 dhe Mostina. S1-O2-Pg1-Pr2: Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lagjen përballë zonës industriale në Lipjan S1-O2-Pg1-Pr3: Asfaltimi i rrugës Lipjan – Drenas (Glllogoc) S1-O2-Pg1-Pr4: Rregullimi i udhëkryqeve në unazat kryesore të qytetit S1-O2-Pg1-Pr5: Asfaltimi i rrugës Slllovi-Terbuvc-Gjilan S1-O2-Pg1-Pr6: Përmirësimi i rrjetit të kanalizimit në Magurë S1-O2-Pg1-Pr7: Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Grackë të Vjetër</p>
		<p>S1-O3:</p>	<p>S1-O3-Pg1: Programi për mbrojtjen e ambientit</p>	<p>S1-O3-Pg1-Pr1: Rregullimi i sipërfaqeve të lira në zonën qendrore të qytetit në harmoni me Planin Zhvillimor Urban</p>

		Përgaditja dhe zbatimimi i planit për modernizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në qytetin e Lipjanit dhe definimi i lokacioneve në zonat rurale deri më 2007		<p>S1-03-Pg1-Pr2: Definimi i lokacioneve për mbledhjen e mbeturinave në zonat rurale</p> <p>S1-03-Pg1-Pr3: Klasifikimi i mbeturinave në qytetin e Lipjanit sipas llojit të tyre</p> <p>S1-03-Pg1-Pr4: Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica dhe evitimi i vërshimeve</p>
S2: Administrata komunale do të ngrisë kapacitetet për ofrim të shërbimeve profesionale dhe të favorshme për komunitetin e biznesit	S2-O1:	Të mundësohet formimi i bordit të ekspertëve, të cilët do të jenë në shërbim të zhvillimit të komunitetit të bizneseve dhe qytetarëve me shërbime dhe ide profesionale, kështu që në fund të vitit 2005 60 % e NVM të jenë të kënaqura me këto shërbime	S2-O1-Pg1: Programi i ndërtimit të mekanizmave për ofrimin e shërbimeve për nevojat e komunitetit të biznesit dhe qytetarëve	<p>S2-O1-Pg1-Pr1: Nxjerrja e një broshure (informatori) në shërbim të bizneseve</p> <p>S2-O1-Pg1-Pr2: Anketimi i bizneseve</p> <p>S2-O1-Pg1-Pr 3 Formimi i bordit të ekspertëve për realizimin e synimeve zhvillimore të komunitetit të biznesit</p>
	S2-O2:	Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e strategjisë nëpërmjet trajnimit të stafit kyç të departamenteve deri në 20% deri në fund të vitit 2005	S2-O2-Pg1: Programi për trajnimin e stafit të administratës komunale	S2-O2-Pg1-Pr1: Trajnimi për intranet dhe internet
	S2-O3:	Të hartohet një plan veprues i cili do të ndikojë në përmirësimin e inkasimit të taksave komunale me qëllim të favorizimit të NVM.	S2-O3-Pg1: Programi për rritjen e efikasitetit në inkasimin e të hyrave vetanake komunale	<p>S2-O3-Pg1-Pr1: Rishikimi i rregullores për tarifa të ngarkesave dhe gjobave</p> <p>S2-O3-Pg1-Pr2: Organizimi i debeteve të cilat do të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes së komunitetit të biznesit në kryerjen e obligimeve ndaj komunës</p>
	S2-O4:	Bashkëpunimi i qeverisë lokale me partnerët afaristë për ngritjen e cilësisë	S2-O4-Pg1: Programi për përkrahje profesionale të trajnimit të stafit të NVM në fusha të caktuara	S2-O4-Pg1-Pr1: Trajnimi për kontabilitet

		për ngritjen e cilësisë profesionale veçmas në lëmi të caktuara si informatikë, administratë, statistikë, kontabilitet, marketing, etj., nga institucione profesionale për ngritjen e profesionalizmit deri në 2007 rreth 90 % e stafit të trajnuar	të caktuara	S2-O4-Pg1-Pr2: Trajnimi për kompjutorë
S3: Përmirësimi i pozitës së qytetarit në shoqëri me mundësi të barabarta të trajnimit dhe të punësimit	S3-O1: Të bëhet trajnimi i një numri të konsideruar të femrave dhe formimi i pesë ekipeve profesionale për të ofruar shërbime në edukimin shëndetsor për komunitete	S3-O1-Pg1: Programi për realizimin e barazisë gjinore në fushën e edukimit dhe punësimit		S3-O1-Pg1-Pr1: Përgatitja e projektit për formimin e disa ekipeve komunale për ofrim të ndihmës në edukimin shëndetsor
	S3-O2: Rikualifikimi i femrës në viset rurale me qëllim të përmirësimit të pozitës së saj në punësim gjatë viteve 2005-2007, deri në 20% (sera, miniferma, artizanate, servise, etj)	S3-O2-Pg1: Programi për rikualifikimin e femrës në përputhje me kërkesat e kohës		S3-O2-Pg1-Pr1: Inicimi, identifikimi, dhe mbajtja e programeve trajnuese për serra, miniferma, artizanate, servise, etj.
S4: Krijimi i kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve nga sektori privat vendor dhe i huaj	S4-O1: Që nga fundi i vitit 2005 qeveria lokale të krijoj mundësi reale për mbështetje të zhvillimit të hovshëm të ndërmarrjeve prodhuese numri i të cilave do të rritet deri në 20 % në krahasim me një vit më parë	S4-O1-Pg1: Krijimi i ambientit të përshtatshëm për zhvillimin e NVM		S4-O1-Pg1-Pr1: Themelimi i zyrës për shërbime të shpejta
	S4-O2: Ngritja e infrastrukturës së përshtatshme për zhvillimin e turizmit si Shpella e Mermerit.	S4-O2-Pg1: Sigurimi i kushteve për zhvillimin e turizmit		S4-O1-Pg1-Pr2: Ngritja e inkubatorit të biznesit
				S4-O2-Pg1-Pr1: Asfaltimi i rrugës deri në Blinajë

		turizmit si Shpella e Mermerit, Parku Nacional Blinaja, uji termik në Bainsë, deri më 2007		S4-O2-Pg1-Pr2: Hulumtimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Lipjan
		S4-O3: Hulumtimi i potencialeve minerale tokësore, nëntokësore dhe bujqësore dhe mundësitë për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tyre deri në fund të vitit 2006	S4-O3-Pg1: Programi për hulumtimin e pasurive minerale	S4-O3-Pg1-Pr1: Definimi i hapsirave dhe përbërjes cilësore dhe sasiore të pasurive minerale
			S4-O3-Pg2: Programi për hulumtimin e tokës bujqësore	S4-O3-Pg2-Pr1: Klasifikimi i sipërfaqeve të tokës sipas bonitetit të tyre
		S4-O4: Deri më 2007 rreth 60 % e ndërmarrjeve të jenë të përfshira në asociacione të ndryshme biznesore	S4-O4-Pg1: Programi për ndërlidhjen e bizneseve me shoqatat e biznesit	S4-O4-Pg1-Pr1: Identifikimi i lidhjeve sektoriale dhe rajonale për krijimin e shoqatave afariste
		S4-O5: Deri në shtator të 2007 komuna do të siguroj qasje të lehtë për biznese në zonën industriale	S4-O5-Pg1: Programi për qasje më të lehtë në zonën e re industriale për biznese	S4-O5-Pg1-Pr1: Lirimi nga taksat në afat prej dy vite për NVM prodhuese të cilat punësojnë më shumë se 10 punëtorë
				S4-O5-Pg1-Pr2: Sigurimi i tokës pa qira në afat prej tri vite për NVM prodhuese që punësojnë më shumë se 20 punëtorë
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Magura është vendbanim me karakter qyteze, ka rreth 3000 banorë. Në këtë vendbanim janë të koncentruara hapësira të banimit individual dhe kolektiv, objekte arsimore, shëndetësore, administrative, publike, si dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Me karakterin që ka si qendër ndërkomunale dhe industriale, pozita e saj në rajon karakterizohet me ndërlidhje direkte me aeroportin, rajonin e Shalës dhe qendrën komunale në Lipjan, si dhe me hekurudhën industriale që ndërlidh zonën industriale, minierën e magnezitit "Golesh" dhe rezervat e feronikelit në Medvec. Problem i theksuar në këtë vendbanim është mungesa e kanalizimit dhe, si pasojë, ekziston një sistem i pakontrolluar i derdhjes së ujërave të zeza. Për më tepër, si rezultat i dendësisë së madhe të popullsisë dhe aktiviteteve biznesore, është krijuar një kanal i hapur ku derdhen ujërat industriale. Sipas perspektivës, Magura do të jetë një qendër e rëndësishme në rajon dhe përmirësimi i infrastrukturës, në plan të parë rrjeti i kanalizimit, është kusht primar për investime të reja, mjedis të shëndoshë dhe funksionim të bizneseve ekzistuese, sidomos industrisë, e cila ka qenë dhe do të jetë potencial kryesor për zhvillim në të ardhmen. Gjithashtu, realizimi i këtij projekti është pjesë përbërëse e planit zhvillimor urban, si pjesë integrale e Planit Zhvillimor Komunal.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Përmirësimi i infrastrukturës strategjike -Kushte më të mira për popullatën -Përmirësimi i rrethinës afariste me kushte më të favorshme për investime të reja -Krijimi i vendeve të reja të punës 	<p><u>Grupet e Synuara</u></p> <p>Qytetarët Komuniteti biznesot Investitorët potencialë</p>
<p><u>Pjesëmarrësit potencialë dhe përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Pushteti lokal -Ndërmarrjet ndërtimore perms procesit të tenderit -Sektori privat 	<p><u>Pjesëmarrësit potencialë dhe përfituesit</u></p> <p>Mbështetësit e projektit Mbështetësit financiarë</p>
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Pushteti lokal është përcaktuar që ta mbështesë projektin dhe t'i stimulojë grupet e komunitetit dhe bizneset që të inkuadrohen në realizimin e projektit -Ekzistimi i udhëheqësit të projektit 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <p>Mungesa e mjeteve financiare Kushtet e papritura teknike</p>
<p><u>Shpenzimet e llogaritura:</u></p> <p>Kostoja e vlerësuar 150,000 €</p>	
<p><u>Koha për implementim</u></p> <p>Fillimi i procesit: 2005 Realizimi: 2006</p>	<p><u>Koha për veprim</u></p> <p>-Menjëherë pas përfundimit të punimeve do të fillojnë të përmirësohen kushtet për veprimtari afariste dhe hapat në drejtim të zgjerimit të bizneseve do të jenë të dukshëm, duke përfshirë edhe krijimin e bizneseve të reja</p>

<p align="center"><u>Projekti 11:</u></p> <p align="center"><u>Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Grackë të Vjetër</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Investimet në infrastrukturën strategjike fizike</u></p>
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Intervenimet në këtë projekt do ta mënjanojnë rrezikun nga ujërat e zeza, që janë pengesë për një ambient të shëndoshë. Kjo do të ndikonte në rritjen e bizneseve ekzistuese dhe në inkurajimin e bizneseve të reja. Realizimi i këtij projekti është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm, ngase përfiton popullata e këtyre lagjeve, si dhe harmonizohen veprimtaritë kryesore në qytet, që formëson një ambient urban - mjedis ekologjikisht të ruajtur</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i kushteve të mjedisit - Kushte më të mira për popullatën - Inkurajimi i bizneseve private 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Popullsia - Ndërmarrjet ekzistuese që dëshirojnë ta zgjerojnë veprimtarinë e tyre
<p><u>Pjesëmarrësit potencialë dhe përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pushteti lokal - Ndërmarrjet ndërtimore përmes procesit të tenderit - Komuniteti i biznesit 	<p><u>Kontributet potenciale në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbështetës të projektit - Udhëheqës të projektit - Mbështetje financiare përmes agjencioneve dhe përfituesve
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekt me prioritet - Pushteti lokal është përcaktuar që ta mbështesë projektin dhe t'i stimulojë grupet e komunitetit dhe inkuadrimin e bizneseve në realizimin e projektit - Ekzistimi i udhëheqësit të projektit 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Burimet e kufizuara financiare për implementimin e projektit - Potencial i vogël afarist
<p><u>Shpenzimet e llogaritura:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kostoja e vlerësuar 100,000€ 	
<p><u>Koha për implementim</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Fillimi i procesit: 2005 - Realizimi: 2006 	<p><u>Koha për veprim</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ky projekt është shumë i rëndësishëm për komunitetin, por edhe për sektorin e NVM-ve, andaj sistemi i kanalizimit është njëra prej çështjeve thelbësore

<p align="center"><u>Projekti 12:</u></p> <p align="center"><u>Rregullimi i sipërfaqeve të lira në zonën gendrore të qytetit</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Investimet në infrastrukturën strategjike fizike</u></p>
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Zona që përfshin qendra e qytetit në Lipjan përfshin rrugët, të cilat formojnë bërthamën e qytetit: rrugët "Shqipëria", "Lidhja e Prizrenit", "Shën Flori" dhe "Skënderbeu". Në këtë zone kryesisht janë të koncentruara hapësirat me objekte banimi - kolektive, publike dhe të përziera. Pjesë e rëndësishme e kësaj zone është edhe sheshi "Adem Jashari". Duke analizuar gjendjen ekzistuese të sipërfaqeve të lira, konstatohet se ka mungesë të madhe të tyre, si pasojë e vendosjes së objekteve të karakterit të përkohshëm dhe ndërtimeve të tjera pa leje dhe vendparkingjeve që në mënyrë të pakontrolluar shkaktojnë kaos në këto zona në raport me dendësinë së banimit. Sipas Planit Zhvillimor Urban është paraparë rregullimi i këtyre hapësirave, që mundëson krijimin e një ambienti urban, ku vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rikultivimit të gjelbërimit ekzistues dhe sipërfaqeve të reja ku parashihet gjelbërimi, i cili kultivohet në Blinajë. Implementimi i këtij projekti do të ndikonte në krijimin e bërthamës së qytetit, si iniciator i pjesëve tjera të infrastrukturës, rregullimin e sipërfaqeve të lira, duke krijuar një ambient të pastër, harmonizimin e pjesëve të banimit dhe atyre tregtare, si dhe ndërlidhjen urbane në një mjedis të rregulluar urban dhe ekologjikisht të ruajtur.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Përmirësimi i infrastrukturës fizike -Kushte më të mira për popullatën -Përmirësimi i ambientit dhe ruajtja e vlerës urbane që karakterizon qytetin 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Popullsia -Komuniteti i biznesit -Investitorët potencialë
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Pushteti lokal është përcaktuar që ta mbështesë projektin dhe t'i stimulojë grupet e komunitetit dhe bizneset që të inkuadrohen në realizimin e projektit -Ekzistimi i udhëheqësit të projektit 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Financimi i pamjaftueshëm -Problemet me pronën private
<p><u>Pjesëmarrësit potencialë dhe përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Pushteti lokal -Ndërmarrjet ndërtimore përmes procesit të tenderit -Sektori privat 	<p><u>Kontributet potenciale në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Pjesëmarrja me mjete financiare -Mbështetës të projektit
<p><u>Shpenzimet e llogaritura:</u></p> <p>Kostoja e vlerësuar 30,000€</p>	

<p align="center"><u>Projekti 13:</u></p> <p align="center"><u>Definimi i lokacioneve për mbledhjen e mbeturinave në zonat rurale</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Mbrojtja e ambientit</u></p>
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Hedhja e mbeturinave në shumicën e lokaliteteve të komunës tonë bëhet nëpër përroska ose në vende të hapura pa kurrfarë trajtimi gjë që, pos ndotjes së ambientit, rrezikon edhe popullsinë nga përhapja e ndonjë epidemie. Me qëllim të mbrojtjes së ambientit dhe shëndetit të popullatës, është i nevojshëm trajtimi adekuat i mbeturinave. Kjo do të arrihet me furnizimin e lokaliteteve me kontenjerë dhe me caktimin e deponive për grumbullim. Hartimi i një projekti, në bazë të të cilit do të caktoheshin deponitë për grumbullim të mbeturinave, do të ishte zgjidhja më e mirë për të filluar zgjidhjen e këtij problemi të pazgjidhur deri tani për shumë fshatra të komunës tonë. Nga deponitë për grumbullim mbeturinat do të vendosen në deponë rajonale për mbeturina.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtja e ambientit - Parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse - Rritja e vetëdijes së qytetarëve për ruajtjen e ambientit 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuniteti
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Ambientit - Komuniteti - Qeveria lokale 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkëfinancues i mundshëm i projektit - Mbështetje financiare - Asistencë financiare dhe teknike
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Lokacioni - Projekt me prioritet - Deponia e hedhurinave - Gatishmëria e ndërmarrjes "Vëllazërimi" për bartjen e mbeturinave 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Dështimi në gjetjen e donatorëve - Buxheti i dobët i komunës
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Faza I: 2005-2006 10 000 €</p> <p>Faza II: 2006-2007 12 000 €</p> <p>Gjithsej: 22 000 €</p>	
<p><u>Periudha e implementimit</u></p> <p>2 vite</p> <p>Faza I: 2005</p> <p>Faza II: 2006</p>	<p><u>Përfundimi</u></p> <p>Projekti niset në fillim të vitit 2005</p> <p>Përfundon në fund të vitit 2006</p>

<p align="center"><u>Projekti 14:</u></p> <p align="center"><u>Klasifikimi i mbeturinave në qytetin e Lipjanit, sipas llojit të tyre</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i projektit:</u></p> <p align="center"><u>Rritja e pastërtisë;</u> <u>Ambienti i pastër;</u> <u>Krijimi i kushteve të mira për jetesë.</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Qeveria lokale do të realizojë projektin për pastrimin, grumbullimin dhe vendosjen e kontenjerëve të mbeturinave sipas llojit të tyre. Realizimi i këtij projekti ndikon në krijimin e një klime më të mirë për jetesë të qytetarëve, rritjen e pastërtisë së qytetit, si dhe mundëson krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për një jetë më të mirë.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ambienti i pastër ekologjik - Nxitja e zhvillimit të ndërmarrësve të rinj - Kushte më të mira për jetë 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qytetarët - Ndërmarrësit - Investitorët
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Komuniteti - Biznesi privat 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Mbështetje teknike dhe financiare - Asistencë teknike
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston udhëheqësi i projektit - Zotimi i institucioneve qeveritare kompetente 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e fondeve për realizimin e projektit
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Pajisje: 30.000 euro Paga: 10.000 euro Shpenzime variabile: 10.000 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>2 vite</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2006-2007</p>

<p><u>Projekti 15:</u> <u>Ndërtimi i shtrattit të lumit Sitnica</u></p>	<p><u>Lloji i projektit:</u> <u>Përmirësimi i kushteve për mbrojtjen e mjedisit</u></p>
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Lumi "Sitnica" kalon nëpër territorin e Lipjanit - qytetit, përkatësisht në pjesën jugore të qytetit. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të ujërave nëntokësore, sasinë e të reshurave dhe konfiguracionin e terrenit - i rrafshët, që për momentin shkakton vërshime në pjesën urbane të lagjes jugore të Lipjanit, si dhe në pjesët bujqësore përreth, ndërtimi i mureve përgjat dy anëve të lumit është konsideruar si domosdoshmëri.</p> <p>Ndërtimi i mureve të pjerrëta do të parandalojë përmytjet dhe dëmet që shkaktohen rrugëve, lagjeve dhe objekteve të banimit, si dhe sipërfaqeve të tokave bujqësore, që arsyeton faktin në fjalë.</p> <p>Kjo do të ndikojë edhe në hapat e mëtejme të realizimit të Planit Zhvillimor Urban të qytetit, sidomos me krijimin e unazës ndërlidhëse të pjesës lindore dhe perëndimore, si dhe me krijimin e zonës rekreative me krijimin e liqeneve artificiale që mundëson hapësira ekzistuese dhe lumi.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Përmirësimi i infrastrukturës fizike -Nxitja e zhvillimit të bizneseve -Përmirësimi i kushteve të mjedisit -Eliminimi i dëmeve nga vërshimet 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Pushteti lokal -Popullsia -Komuniteti i biznesit
<p><u>Pjesëmarrësit potencialë dhe përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Sektori privat -Pushteti lokal -Donatorët potencialë 	<p><u>Kontributet potenciale në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbështetje të projektit dhe kontribut material -Udhëheqës të projektit
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Projekt me prioritet -Ekzistimi i udhëheqësit të projektit 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mjetet financiare-burimet e kufizuara -Potenciali i vogël afarist -Problemet me prona
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Kostoja e vlerësuar: 300.000€</p>	
<p><u>Koha për implementim</u></p> <p>Fillimi i procesit: 2005 Realizimi: 2007</p>	<p><u>Koha për veprim</u></p> <p>-Menjëherë pas një viti rezultatet e projektit do të jenë të dukshme, që është shumë me rëndësi për qytetarët e Lipjanit dhe më gjerë</p>

<p align="center"><u>Projekti 16:</u></p> <p align="center"><u>Nxjerrja e një broshure - informatë në shërbim të bizneseve</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Investimet publike</u></p>
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Realizimi i këtij projekti do t'u ndihmojë biznesmenëve të cilët janë të interesuar që të zgjerojnë biznesin e tyre ose të fillojnë ndonjë biznes të ri, por të cilët kanë mungesë të burimeve financiare për fillimin e biznesit të tyre. Me këtë udhëzues, biznesmenët do të marrin informata relevante rreth kushteve të kreditimit të bankave. Përfitues të këtij projekti janë biznesmenët dhe qeveria lokale.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i vendeve të reja të punës - Stimulimi i zhvillimit të bizneseve private - Inkurajimi për fillimin e bizneseve të reja 	<p><u>Përfituesit</u></p> <p>Komuniteti Komuniteti i biznesit Administrata lokale</p>
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Biznesmenët ekzistues - Biznesmenët e ardhshëm - Qeveria lokale 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësi i projektit - Përkrahësit e projektit - Përkrahësit financiarë
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekzistimi i një numri të madh të biznesmenëve - Ekzistimi i njerëzve me ide për biznes, të cilët kanë nevojë për ndihmë financiare -Përkrahja e komunitetit për inkuadrin në implementimin e projektit 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Buxheti i pamjaftueshëm - Kushtet e donatorëve
<p><u>Shpenzimet e përloqaritura</u></p> <p>5.000 €</p>	
<p><u>Periudha e implementimit</u></p> <p>3 muaj</p>	<p><u>Përfundimi</u></p> <p>Fundi i vitit 2005</p>

<p align="center"><u>Projekti 17:</u></p> <p align="center"><u>Anketa me komunitetin e biznesit</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Investimet në infrastrukturën institucionale</u></p>
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Projekti mbi anketimin e komunitetit të biznesit ka të bëjë me anketimin e bizneseve të ndryshme në lidhje me efikasitetin e kryerjes së shërbimeve nga organet e administratës komunale dhe kryerjes së obligimeve të bizneseve ndaj organeve komunale, me anë të pyetësorit, i cili përpilohet nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, respektivisht Sektori për Zhvillim Ekonomik. Rëndësi të veçantë kanë bizneset e sektorit të prodhimit, i cili ndikon në rritjen e punësimit. Ky projekt mendohet të realizohet në bashkëpunim me qeverinë lokale dhe asociacionin e biznesit.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Inkurajimi – zhvillimi i bizneseve private - Rritja e transparencës së qeverisë lokale - Kontrollimi më i mirë i produkteve dhe shërbimeve 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuniteti - Komuniteti i biznesit - Administrata lokale
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Komuniteti i biznesit 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësi i projektit - Asistenca teknike dhe puna vullnetare
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - ekzistimi i planit detal të projektit, përpiluar nga sektori për zhvillim ekonomik - Problemet ligjore nuk ekzistojnë - Motivimi i komunitetit të biznesit për pjesëmarrje në implementimin e projektit 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Buxheti i pamjaftueshëm
<p><u>Shpenzimet e përlogaritura:</u></p> <p>3.000 €</p>	
<p><u>Periudha e implementimit</u></p> <p>3 muaj</p>	<p><u>Përfundimi</u></p> <p>2005</p>

<p align="center"><u>Projekti 18:</u></p> <p align="center"><u>Formimi i bordit të ekspertëve për realizimin e synimeve zhvillimore të komunitetit të biznesit</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i projektit:</u></p> <p align="center"><u>Përmirësimi i klimës investuese të bizneseve lokale dhe rajonale</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Qeveria lokale do të realizojë projektin për formimin e bordit të ekspertëve profesionalë, me qëllim të dhënies së këshillave dhe të informimit të biznesmenëve për realizimin e synimeve të zhvillimit të tyre ekonomik, me qëllim të përparimit të sektorit privat, por gjithnjë duke bashkëpunuar me qeverinë lokale.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i klimës investuese - Nxitja e zhvillimit të ndërmarrësve të rinj - Kushte më të mira për biznesin privat 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërmarrësit - Investitorët
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Komuniteti - Biznesi privat 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Mbështetje teknike dhe financiare - Asistencë teknike
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston udhëheqësi i projektit - Zotimi i institucioneve qeveritare kompetente 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e fondeve për realizimin e projektit
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për realizimin e këtij projekti llogarisim të shpenzojmë rreth 5.000 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>6 muaj</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2006</p>

<p align="center"><u>Projekti 19:</u></p> <p align="center"><u>Trajnimi i stafit komunal në teknologjinë informative</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u></p> <p align="center"><u>Investimet në infrastrukturën humane; Përmirësimi i kapaciteteve të qeverisë lokale në mbështetjen e biznesit.</u></p>
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Trajnimi i stafit komunal në lidhje me teknologjinë informative është hartuar me qëllim të organizimit të trajnimeve për stafin komunal në fushën e përdorimit të kompjuterëve dhe teknologjive të tjera. Nëpërmjet disa trajnimeve të mbajtura më parë, niveli i përdorimit të teknologjise nuk është i kënaqshëm. Ky projekt do të ngrisë aftësitë e stafit komunal në shfrytëzimin e kësaj teknologjie. Trajnimet do të përfshijnë kurset për fillestarë dhe kurset e avancuara, duke përfshirë programe speciale dhe programet e internetit. Kurset për fillestarë do të mbahen nga stafi komunal, të cilët tashmë kanë marrë njohuri nga trajnimet e tilla të ngjashme, përderisa kurset e avancuara do t'i mbajnë ekspertët e fushave të ndryshme dhe trajnime të veçanta.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e efikasitetit dhe nivelit profesional të shërbimeve administrative komunale - Rritja e komunikimit ndërmjet nivele të ndryshme brenda administrates lokale, si dhe ndërmjet administratës lokale me nivelet më të larta administrative 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Stafi administrativ i komunës si përfitues direkt i trajnimeve të organizuara -Të gjithë klientët të cilët marrin shërbime kualitative, si përfitues indiret
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësi i projektit - Partnerët implementues, të cilët ofrojnë përkrahje teknike dhe financiare
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e financave të projektit - Gatishmëria e stafit për të marrë pjesë në trajnime 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e ekspertëve lokalë për organizimin e këtyre trajnimeve
<p><u>Shpenzimet e përllogaritura: € 10,000</u> 10,000 €</p> <p>Fondet financiare sigurohen nga buxheti komunal. Por, partnerët potencialë nga organizatat ndërkombëtare, të cilët ofrojnë asistencë teknike, i rrisin performansat e projektit.</p>	
<p><u>Periudha e implementimit</u></p> <p>6 muaj</p>	<p><u>Përfundimi</u></p> <p>Fundi i 2005</p>

<p align="center"><u>Projekti 20:</u></p> <p align="center"><u>Rishikimi i rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i projektit:</u></p> <p align="center"><u>Inkurajimi i shtimit të biznesit dhe ndërmarrjeve të reja</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Për t'iu përgjigjur nevojave zhvillimore të bizneseve e kemi parë të arsyeshme të bëjmë rishikimin e rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim do të bëjë realizimin e këtij projekti, përmes ekspertëve të kësaj lëmie, të cilët edhe më parë kanë punuar në hartimin e rregulloreve ekzistuese. Grupi punues do të bëjë ndryshimet në aspektin pozitiv që të ndikohet në krijimin e kushteve sa më favorizuese për bizneset të cilat operojnë në tërë territorin e komunës sonë.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Arkëtimi i qëndrueshëm i mjeteve në BK - Krijimi i besimit reciprok QL-Biznese - Inkurajimi i shtimit të ndërmarrjeve 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrata lokale - Ndërmarrësit - Komuniteti
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Komuniteti - Biznesi privat 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Punësimi qëndrueshëm - Asistencë teknike
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston udhëheqësi i projektit - Zotimi i institucioneve qeveritare kompetente 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mosgatishmëria e autoriteteve lokale për t'i hyrë ndryshimit të kësaj rregulloreje
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për realizimin e këtij projekti llogarisim të shpenzojmë rreth 500 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>1 muaj</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2005</p>

<p><u>Projekti 21:</u></p> <p><u>Organizimi i debateve, të cilat do të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes së komunitetit të biznesit në kryerjen e obligimeve komunale</u></p>	<p><u>Lloji i projektit:</u></p> <p><u>Inkurajimi i shtimit të biznesit dhe ndërmarrjeve të reja</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Qeveria lokale do të realizojë projektin për organizimin e debateve me qytetarët e saj, me qëllim të vetëdijësimit të tyre në kryerjen e obligimeve ndaj administratës komunale. Kryerja e obligimeve ndaj administratës komunale ndikon në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e komunitetit të biznesit dhe qytetarëve. Qytetarët do të binden se ka përparësi të shumta që do t'u sjellë kryerja e këtyre obligimeve, sepse të gjitha ato mjete janë mjete për ta dhe ju kthehen atyre që u janë marrë.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i klimës investuese - Nxitja e zhvillimit të ndërmarrësve të rinj - Kushte më të mira për biznesin privat 	<p><u>Përfituesit</u></p> <p>Administrata lokale Ndërmarrësit Investitorët</p>
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Komuniteti - Biznesi privat 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Mbështetje teknike dhe financiare - Asistencë teknike
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston udhëheqësi i projektit - Zotimi i institucioneve qeveritare kompetente 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e fondeve për realizimin e projektit
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për realizimin e këtij projekti llogarisim të shpenzojmë rreth 2.000 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>6 muaj</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2005</p>

<p><u>Projekti 22:</u></p> <p><u>Trajnimi për kontabilitet</u></p>	<p><u>Lloji i projektit:</u></p> <p><u>Investimet në infrastrukturën institucionale</u></p> <p><u>Krijimi i stafit profesional.</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Qeveria lokale do të bëjë trajnimin intensiv të stafit të vet dhe biznesit privat, me qëllim që shërbimet ndaj qytetarëve dhe bizneseve të jenë sa më korrekte, profesionale dhe të shpejta. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në krijimin e një partneriteti të mirëfilltë ndërmjet komunitetit dhe qeverisë lokale. Trajnimet e tilla në partneritet me komunitetin e biznesit do të ndihmonin shumë në evidencat kontabile, të cilat janë të obliguara t'i udhëheqin ndërmarrjet për bizneset e tyre.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i klimës së bashkëpunimit - Krijimi i një partneriteti të qëndrueshëm - Kushhte më të mira për biznesin privat 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrata lokale - Ndërmarrësit - Investitorët
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Shoqata e kontabilistëve - Biznesi privat 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Mbështetje teknike dhe financiare - Asistencë teknike
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësi i projektit ekziston - Zotimi i institucioneve qeveritare kompetente 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e fondeve për realizimin e projektit
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për realizimin e këtij projekti llogarisim të shpenzojmë rreth 3.000 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>1 vit</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2006</p>

<p align="center"><u>Projekti 23:</u></p> <p align="center"><u>Trajnimi për kompjuter</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i projektit:</u></p> <p align="center"><u>Investimet në infrastrukturën e butë;</u> <u>Krijimi i stafit profesional.</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Me këtë projekt parashihet të ndihmohen bizneset e interesuara në lëmitë e caktuara për të përfituar njohuritë themelore në TI në WORD dhe EXCEL. Ky projekt do të realizohet me bashkëpunimin qeveri lokale-komunitet i biznesit dhe OJQ.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i klimës së bashkëpunimit - Krijimi i një partneriteti të qëndrueshëm - Kushte më të mira për biznesin privat 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrata lokale - Ndërmarrësit - Investitorët
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - OJQ-të - Biznesi privat 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Mbështetje teknike dhe financiare - Asistencë teknike
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston udhëheqësi i projektit - Zotimi i institucioneve qeveritare kompetente 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e fondeve për realizimin e projektit
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për realizimin e këtij projekti llogarisim të shpenzojmë rreth 3.000 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>1 vit</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2006</p>

<p align="center"><u>Projekti 24:</u></p> <p align="center"><u>Formimi i ekipeve komunale për ofrimin e ndihmave në edukimin shëndetësor</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i projektit:</u></p> <p align="center"><u>Investime në infrastrukturë</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Realizimin e këtij projekti do ta bëjë qeveria lokale në bashkëpunim me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Lipjan. Meqenëse Lipjani ka një numër të madh të fshatrave të cilat janë në përgjithësi me një standard të ulët të zhvillimit ekonomik, ka nevojë për formimin e disa ekipeve komunale të cilat do t'i ofronin ndihmë komunitetit në edukimin shëndetësor. Realizimi i këtij projekti do të jetë masë preventive për shfaqjen e disa sëmundjeve, të cilat mund të jenë si rezultat i mungesës së njohurive nga lëmia e edukimit shëndetësor. Në realizimin e këtij projekti do të inkuadrohen edhe profesionistë të lëmive të caktuara nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Më së shumti do të përfitojnë nënat shtatzëna.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Parandalimi i shfaqjes së sëmundjeve - Angazhimi i femrës në punë - Ngritja e vetëdijës në edukimin shëndetësor 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Viset rurale - Shtresa e varfër - Gjinia femërore
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qendra e Mjekësisë Familjare - Qeveria lokale - Donatorët 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i personelit - Udhëheqës i projektit - Mbështetje financiare
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston projekti - Gatishmëria e qeverisë lokale për përkrahje 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e fondeve për realizimin e projektit - Interesimi i donatorëve
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për realizimin e këtij projekti llogarisim të shpenzojmë rreth 5.000 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>6 muaj</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2005</p>

<p align="center"><u>Projekti 25:</u></p> <p align="center"><u>Ofrimi i trajnimeve për miniferma, artizanate, serra, servise</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i projektit:</u></p> <p align="center"><u>Investime në rikualifikimin dhe në realizimin e barazisë gjinore në punësim</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Duke pasur parasysh se pozita e femrës është në përgjithësi jo e mirë për nga aspekti i trajtimit të pabarabartë në punësim dhe trajnim, qeveria lokale në bashkëpunim me Zyrën për çështje gjinore, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së kryeshefit të Ekzekutivit, do ta realizojë këtë projekt, i cili do të krijojë mundësinë për inkuadrimin e të gjitha femrave që shprehin dëshirë dhe vullnet të mirë, pa dallim përkatësie, duke përfshirë edhe ato me AK dhe nevoja të veçanta, e sidomos nënat kryefamiljare, për përmirësimin e pozitës së tyre në shoqëri. Përmes këtij projekti do të bëhet trajnimi i një numri të femrave në viset rurale, me qëllim të përmirësimit të pozitës së tyre në punësim gjatë viteve 2005 deri në 2007 deri në 20% serra, miniferma, artizanate, servise etj.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mundësia më e lehtë për punësim - Rritja e cilësisë për punë - Mundësia për përfshirjen e femrës në shoqëri 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Femra në viset më pak të zhvilluara - Komuniteti - Qeveria lokale
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Donatorët 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Mbështetje financiare
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekt me prioritet - Gatishmëria e qeverisë lokale për këtë projekt 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e fondeve për realizimin e projektit - Interesimi i donatorëve
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për realizimin e këtij projekti llogarisim të shpenzojmë rreth 5.000 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>6 muaj</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2005</p>

<u>Projekti 26:</u> <u>Themelimi i Zyrës për shërbime të shpejta</u>	<u>Lloji i programit:</u> <u>Inkurajimi për ndërmarrje të reja;</u> <u>Aftësimi i rrethinës lokale afariste;</u> <u>Investimi në resurse humane;</u> <u>Zvogëlimi i varfërisë.</u>
<u>Përshkrimi i projektit</u> Një apo më shumë punëdhënës nga administrata do të ofrojnë informata themelore mbi kërkesat për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve, procedurat dhe shpenzimet. Zyra mund të veprojë si ndërmjetësuese për ndërmarrësit gjatë nxjerrjes së lejeve dhe licencave. Për më tepër, zyra mund të ofrojë lloje të tjera të informacioneve si: kontakte afariste, shanse për investime të përbashkëta. Zyra mund të shpërndajë informata lidhur me ndryshimet në legjislacion apo në procedurat administrative nga institucionet apo departamentet tjera.	
<u>Rezultatet e pritshme</u> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi rrethinës afariste (i përshtatshëm për investimet e vendit dhe të jashtme) - Rritja e numrit të bizneseve (qasje më e lehtë ndaj informatave) - Rritja e kontributit të sektorit privat në buxhetin lokal 	<u>Përfituesit</u> Ndërmarrësit dhe Ndërmarrjet
<u>Akterët e mundshëm</u> <ul style="list-style-type: none"> - Shoqatat e biznesit dhe sektori privat - Institucionet e përfshira në regjistrimin dhe licencimin e bizneseve 	<u>Kontributet e mundshme në projekt</u> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësi i projektit - Mbështetësi i projektit - kontribut material (pajisje) - Ofron përkrahje direkte (objekte, mbështetje politike) - Ofron informata sipas kërkesave specifike - Mbështetje financiare - Mund të ofrojë informata dhe shanse
<u>Parakushtet</u> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston udhëheqësi i projektit - Ekziston një konsensus dhe zotim i departamenteve që janë të përfshira në aspektet ligjore dhe administrative të afarizmit 	<u>Faktorët e rrezikut</u> <ul style="list-style-type: none"> - Kufizimet buxhetore - Stafi shtesë i zyrës - Ndërmarrësit nuk iu besojnë zyrtarëve
<u>Shpenzimet e përloqaritura</u> Stafi (3 veta) – pagat: 5.000 € Pajisje: 4.000 € Shpenzimet variabile: 1.000 € Gjithsej: 10.000 €	
<u>Periudha e implementimit</u> <ul style="list-style-type: none"> - Kohëzgjatja në vazhdimësi - Koha e fillimit: Gjashtëmuajori i parë i vitit 2005 	<u>Përfundimi</u> Vlerësimi: çdo vit Kriter do të jetë anketimi

<p align="center"><u>Projekti 27:</u></p> <p align="center"><u>Ngritja e inkubatorit të biznesit</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i projektit:</u></p> <p align="center"><u>Inkurajimi i bizneseve të reja;</u> <u>Avancimi i bizneseve të vogla;</u> <u>Zhvillimi kompleks i bizneseve.</u></p>
<p><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></p> <p>Ekonomia e komunës së Lipjanit në periudhën e viteve të paraluftës, gjatë okupimit të regjimit serb, si edhe gjatë luftës, pësoi dëme të mëdha, kështu që as edhe deri sot nuk po arrin t'i rehabilitojë potencialet e veta ekonomike. Duke u bazuar në faktet se komuna ka një shkallë të lartë të papunësisë dhe nivel të ulët të vetëfinancimit, shtrohet domosdoshmëria që në strategjinë e zhvillimit të komunës, aktivitetin e vet mbi të gjitha ta orientojë në zhvillimin dhe në përkrahjen e NVM-ve, e në kontekst të kësaj edhe në krijimin e një inkubatori të biznesit në territorin e komunës. Inkubatori do të paraqesë hapësira afariste për ato biznese fillestare të cilat kanë nevojë në lehtësira financiare, siç është qiraja e ulët për këto biznese për tri vitet e para të punës. Lipjani ka objektin të cilin mund ta dedikojë për një qëllim të tillë.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Inkurajimi i bizneseve të reja - Avancimi i bizneseve të vogla - Shtimi i numrit të të punësuarve - Përmirësimi i ambientit të biznesit 	<p><u>Përfituesit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërmarrësit - Administrata lokale - Komuniteti - Bizneset e reja
<p><u>Akterët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Biznesi privat - Donatorët 	<p><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Objekti, participimi financiar dhe menaxhimi - Selektimi i bizneseve dhe nënshkrimi i kontratave për qira
<p><u>Parakushtet</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston udhëheqësi i projektit - Zotimi i institucioneve qeveritare kompetente 	<p><u>Faktorët e rrezikut</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e fondeve për realizimin e projektit - Interesimi i donatorëve
<p><u>Shpenzimet e llogaritura</u></p> <p>Për realizimin e këtij projekti llogarisim të shpenzojmë rreth 120.000 euro</p>	
<p><u>Koha e implementimit</u></p> <p>6 muaj</p>	<p><u>Fillimi i punëve</u></p> <p>2005</p>

